



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË
KAVAJË

Adresa: Bulevardi „Josif Budo“

Kavaje me, 04/03/2016

VENDIM

Nr. 10, datë 04.03.2016

NE MBLEDHJEN E RRADHES, KESHILLI I BASHKISË KAVAJË MORI NE SHQYRTIM PROJEKT-VENDIMIN E PARAQITUR NGA DREJTORIA E KONTROLLIT, ZHVILLIMIT URBANISTIK DHE PRONAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, NGA BASHKIA KAVAJË MINISTRIT TË SHETITIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 494 M2 NË KATIN E PARË TË PRONËS ME EMËRTIM “PALLATI I KULTURËS KAVALJON, KAVAJË, ME VENDNDODHJE NË ADRESËN SHËTITORJA “JOSIF BUDA”, PËR VENDOSJEN E QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA), në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të VKM-në Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, nenet 9/1.2 dhe 55/4 me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Kavajë Për Dhënie në Përdorim të përkohshëm të ndërtesës me emërtimin “Pallati i Kulturës i Kavajës,, Kati i Parë, me vendndodhje në adresën Shëtitörja “Josif Buda” për vendosjen e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)-Kavajë, i kërkoi Këshillit të Bashkisë Kavajë, dhe

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, sipas përcaktimeve të mëposhtme, për një periudhë 20 (njëzet) vjeçare, të pronës me emërtim *Pallati i Kulturës së Kavajës, (totali i sipërfaqes së katit të parë që jepet në përdorim është 494m2, dhe dy zyra të tjera që ndodhen në Pallatin e Kulturës Kavaljon)*, me vendndodhje në adresën “Shëtitörja Josif Buda”, nga Bashkia e Kavajës, Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e punonjësve të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) - Kavajë.

2. Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Bashkia e Kavajës, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefektura Tiranë..

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Valbona MUSTAFA



KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

Aqif PEZA

